



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1172/11 prot.

Datë 26.05.2025

V E N D I M

Nr. 693/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.05.2025 me

Objekt:

“Ekspertizë teknike e posaçme, për përllogaritjen në vlerën minimale dhe maksimale të fondit limit për procedurën e prokurimit, “Procedurë e hapur e thjeshtuar me mjete elektronike”, me nr. REF-44148-04-08-2025, me objekt: “Mbikëqyrje punimesh për objektin: Ndërtim-montim i disa RVM-ve në Qendrat e Albpetrol Sh.A”, me fond limit: 1,249,423.86 (një milion e dyqind e dyzet e nëntë mijë e katërqind e njëzet e tre pikë tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 22.04.2025 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol sh.a.

Subjekte të interesuar:

Albpetrol sh.a. me adresë Lagja “29 Marsi” Patos, Selia Rruga Fier – Patos, km 7.

Operatori ekonomik “C.E.C. GROUP” SHPK me NIPT L11807013M dhe adresë Njësia Bashkiake nr. 7, Rruga Dritan Hoxha, Ndërtesa nr. 117, Shkalla nr. 2, Apartamenti nr. 5/3, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Ligji nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Ligji Nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:**I**

I.1. Në datën 09.04.2025, është publikuar nga autoriteti kontraktor, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar me mjete elektronike”, me nr. REF-44148-04-08-2025, me objekt: “Mbikëqyrje punimesh për objektin: Ndërtim-montim i disa RVM-ve në Qendrat e Albpetrol Sh.A”, me fond limit: 1,249,423.86 (një milion e dyqind e dyzet e nëntë mijë e katërqind e njëzet e tre pikë tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 22.04.2025 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol sh.a.

I.2. Në datën 22.04.2025, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

I.3. Në datën 25.04.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. BOE “Bersant Ylli” pf & “XH & MILER” shpk 1,137,946.92 lekë pa TVSH. I Kualifikuar
2. OE “C.E.C GROUP” shpk 1,086,998.76 lekë pa TVSH I Skualifikuar
3. OE “G B Civil Engineering” shpk 1,091,676.4 lekë pa TVSH. I Kualifikuar
4. OE “HYDRO-ENG CONSULTING” shpk 1,112,130 lekë pa TVSH. I Kualifikuar
5. OE “MAGNA CHARTA” shpk 1,144,507.56 lekë pa TVSH. I Kualifikuar
6. OE “MIKI CONSULTING” shpk 1,124,176.97 lekë pa TVSH. I Kualifikuar
7. OE “NET-GROUP” shpk 1,109,229.50 lekë pa TVSH. I Kualifikuar

I.4. Në datën 30.04.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE Njoftimin e Fituesit Paraprak për procedurën e prokurimit si dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 23, datë 05.05.2025, ku është shpallur fitues subjekti OE “G B Civil Engineering” shpk.

I.5. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi A/2025/5292, datë 06.05.2025 dhe me Nr. 1172/2025 Prot., datë 06.05.2025 e operatorit ekonomik “C.E.C. GROUP” SHPK, për procedurën e prokurimit të sipërcituar. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “C.E.C. GROUP” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

I.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. 1172/1 prot, datë 07.05.2025.

I.7. Nëpërmjet komunikimit të postës elektronike më datë 07.05.2025, protokolluar me tonë me nr. 1172/2 prot., datë 09.05.2025, autoriteti kontraktor Albpetrol sh.a. ka njoftuar në adresën e email të institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik Kpp_info@kpp.gov.al., se ka njoftuar operatorin ekonomik “C.E.C. GROUP” SHPK, që në zbatim të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 111 dhe VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 94 pika 4, brenda dy ditëve nga marrja e këtij njoftimi, të paraqesë dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën.

I.8. Nëpërmjet komunikimit të postës elektronike më datë 07.05.2025, protokolluar me tonë me nr. 1172/3 prot., datë 09.05.2025 operatori ekonomik “C.E.C. GROUP” SHPK, ka njoftuar në adresën e email të institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik Kpp_info@kpp.gov.al., se ka kryer pagesën e kërkuar.

I.9. Me shkresën nr. 1172/4 prot., datë 09.05.2025, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua autoritetit kontraktor Albpetrol Sha., për të dërguar informacion mbi përlllogaritjen e fondit limit të procedurës objekt ankimi si edhe të projektit të zbatimit.

I.10. Nëpërmjet komunikimit të postës elektronike autoriteti kontraktor Albpetrol sh.a. ka dërguar në adresën e email të institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik Kpp_info@kpp.gov.al., vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, me shkresën nr. 2334/3 prot, datë 12.05.2025, protokolluar me tonën me nr. 1172/5 prot., datë 13.05.2025,

me objekt: “*Dërgim vendimi*”, lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “C.E.C. GROUP” SHPK, mbi procedurën e mësipërme të prokurimit. Referuar vendimit të KSHA-së, rezulton se kjo e fundit **e ka refuzuar**.

I.11. Nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, operatori ekonomik “C.E.C. GROUP” SHPK, ka dërguar informacion shtesë, protokolluar me tonën me nr. 1172/6 prot., datë 13.05.2025.

I.12. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor Albpetrol sh.a. ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, me shkresën nr. 2334/3 prot, datë 12.05.2025, protokolluar me tonën me nr. 1172/7 prot., datë 19.05.2025, me objekt: “*Dërgim vendimi*” (*Vendimi për shqyrtim ankese me nr. 2334/2 prot., datë 12.05.2025*), lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “C.E.C. GROUP” SHPK, mbi procedurën e mësipërme të prokurimit. Referuar vendimit të KSHA-së, rezulton se kjo e fundit **e ka refuzuar**.

I.13. Nëpërmjet shërbimit postar, operatori ekonomik ankimues ka dërguar informacion, protokolluar me tonën me nr. 1172/8 prot., datë 19.05.2025.

I.14. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor Albpetrol sh.a. ka dërguar me shkresën përcjellëse me nr. 2418/1 prot., datë 19.05.2025, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacionin e kërkuar referuar shkresës me nr. 1172/4 prot., datë 09.05.2025, protokolluar me tonën me nr. 1172/9 prot., datë 22.05.2025.

I.15. Për shkak të specifikës së kësaj procedure prokurimi, Komisioni i Prokurimit Publik për gjykimin sa më të drejtë të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, vendos të thërrasë ekspertin e fushës për të verifikuar nëse përllogaritja e fondit limit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi është bërë konform bazës ligjore të përcaktuar, e më konkretisht Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

I.16. Eksperti zgjidhet nga lista vjetore e ekspertëve të miratuar në përputhje me nenin 24 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik.

I.17. Eksperti i parë në rend alfabetik i cili referuar dokumentacionit zotëron kualifikimet e kërkuara për kryerjen e ekspertizës është Ekspertia Znj.Arta Tani, e cila do të asistojë Komisionin e Prokurimit Publik në zgjidhjen e çështjes objekt-ankimi. Në datën 09.05.2025 u komunikua me telefon, nga telefoni i zyrës së protokollit, eksperti Arta Tani. Eksperti pranon, se është i specializuar për përllogaritjen e kostove për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim dhe përcaktoi tarifën prej 50,000 (pesëdhjetëmijë) lekë për kryerjen e ekspertizës. Pas paraqitjes së saj, në ambientet e Komisionit të Prokurimit Publik u dakortësuar asistenca e saj, në zgjidhjen e çështjes objekt-

ankimi sipas procesverbalit të datës 12.05.2025. Gjithashtu, Ekspertia pranon se për kryerjen e ekspertizës i nevojiten 7 ditë kohë nga marrja e dokumentacionit.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Referuar informacionit dhe dokumentacionit sa më sipër,

Arsyeton:

II.1. Referuar pretendimeve të parashtruara nga ankimuesi në ankesë, KPP konstaton, se për sqarimin e fakteve dhe pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, kërkohen njohuri të posaçme teknike nga ekspertë të specializuar për përllogaritjen e kostove për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim, nëse përllogaritja e fondit limit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është përllogaritur saktë nga autoriteti kontraktor në përputhje me VKM nr. 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Në këto kushte, KPP për një gjykim të drejtë dhe transparent të ankesës, vlerëson të kryhet veprimi procedural i ekspertimit të posaçëm nga një ekspert i fushës.

II.2. Në nenin 24 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik, parashikohet se:

- 1. Nëse gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës Komisioni vlerëson, se për sqarimin e fakteve kërkohen njohuri të posaçme në fushat e shkencës, teknikës, teknologjisë ose artit, Komisioni mund të urdhërojë marrjen e mendimit të ekspertëve ose kryerjen e ekspertizës në laboratorë të specializuar.***
- 2. Ekspertët përzgjidhen nga lista vjetore e ekspertëve të miratuar. Në rast se për shqyrtimin e çështjes kërkohet ekspertizë e posaçme dhe nuk disponohet asnjë ekspert i fushës për të cilën nevojitet ekspertizë në listën e miratuar, mund të kërkohen rast pas rasti ekspertë të pavarur nga institucione të arsimit të lartë ose struktura të tjera të posaçme.***
- 3. Komisioni njofton palët në proces për vendimin e ekspertimit, shpenzimet procedurale dhe datën e zhvillimit të seancës.***

II.3. Në nenin 25 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik, parashikohet se: “Kur Komisioni, në procesin e shqyrtimit të një ankese, urdhëron

thirrjen e specialistëve ose të ekspertëve dhe kryerjen e ekspertizës, duhet të përcaktojë detyrimin e palëve për parapagimin e tyre dhe afatin.”

II.4. Në datën 09.05.2025 u komunikua me telefon, nga telefoni i zyrës së protokollit, Ekspertia Znj.Arta Tani. Eksperti pranon, se është i specializuar për përlllogaritjen e kostove për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim dhe përcaktoi tarifën prej 50,000 (pesëdhjetëmijë) lekë për kryerjen e ekspertizës. Pas paraqitjes së saj në ambientet e Komisionit të Prokurimit Publik u dakortësuar asistenca e tij në zgjidhjen e çështjes objekt-ankimi sipas procesverbalit të datës 12.05.2025. Gjithashtu Ekspertia pranon se për kryerjen e ekspertizës i nevojiten 7 ditë kohë nga marrja e dokumentacionit.

Referuar sa më sipër në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, i ndryshuar, Ligji nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Ligji Nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, nenit 24 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të urdhërojë kryerjen e Ekspertimit të Posaçëm lidhur me përlllogaritjen në vlerën minimale dhe maksimale të fondit limit, nga eksperti i përzgjedhur nga lista e ekspertëve vjetorë të miratuar për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar me mjete elektronike”, me nr. REF-44148-04-08-2025, me objekt: “Mbikëqyrje punimesh për objektin: Ndërtim-montim i disa RVM-ve në Qendrat e Albpetrol Sh.A”, me fond limit: 1,249,423.86 (një milion e dyqind e dyzet e nëntë mijë e katërqind e njëzet e tre pikë tetëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 22.04.2025 nga autoriteti kontraktor, Albpetrol sh.a.
2. Operatori ekonomik “C.E.C. GROUP” SHPK të parapaguajë për llogari të znj. Arta Tani, shumën prej 50,000 (pesëdhjetëmijë) lekë si tarifë e përcaktuar për kryerjen e ekspertimit dhe të verë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik së bashku me kopje të faturës financiare të parapagimit brenda datës 29.05.2025 ora 12:00.
3. Autoriteti kontraktor dhe operatori ekonomik ankimues “C.E.C. GROUP” SHPK të paraqesin pretendimet e tyre me shkrim mbi çështjet që duhet të trajtohen nga Eksperti brenda datës 29.05.2025.
4. Në datën 30.05.2025 ora 12:00 të paraqitet pranë Komisionit të Prokurimit Publik eksperti znj. Arta Tani, për marrjen në dorëzim të dokumentacionit të nevojshëm për kryerjen e ekspertizës.

5. Eksperti ngarkohet të kryejë aktin e ekspertimit dhe të dorëzojë materialin në formë shkresore. Akti i ekspertimit të dorëzohet jo më vonë se data 06.06.2025.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri

